



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE NË QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS
JURIDIKE PARËSORE**

Në zbatim të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike garantuar nga shteti”, Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, shpall procedurat e rekrutimit për vendet e lira si më poshtë vijon:

1. Specialist, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier (2 pozicione)
2. Specialist, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë (2 pozicione)
3. Specialist, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër (2 pozicione)
4. Specialist, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë (1 pozicion)

Qendra e shërbimit të ndihmës juridike falas

Qendra (Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore) është një njësi e specializuar për dhënie e ndihmës juridike parësore, e organizuar si *“njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”*, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, e cila ofron shërbime të ndihmës juridike falas duke garantuar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Kërkesa të posaçme

Kualifikime: “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Eksperienca: Jo më pak se 1 vit eksperiencë në punë si jurist ose avokat

Detyrat kryesore

Punonjësi i qendrës jep ndihmën juridike parësore nëpërmjet:

1. Dhënies së informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor.
2. Dhënies së këshillimit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
3. Dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim, arbitrazh).
4. Dhënies së ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
5. Përfaqësimit përpara organeve administrative;
6. Dhënies në të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Aftësi të tjera

- Të ketë aftësi analitike;
- Të jetë i aftë të marrë vendime dhe të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Fusha e Njohurive

- Të ketë njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjin nr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Të ketë njohuri të plota mbi legjislacionin dhe të drejtën civile, penale dhe administrative;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Kërkesë për pozicionin
- b. Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
- c. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë në Zyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas brenda datës 31.01.2021 , në adresën: **Rruga e Barrikadave, Nd. 18, Hyrja 6, Zyra Nr. 10- III. Tiranë**